



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.433/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjore Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, Komuna e Ferizajit, Genc Bekteshi, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e parregullt ankesa ZL.A.nr.433/2017, i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajit, Genc Bekteshi, nga Ferizaj, e paraqitur me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajit, Genc Bekteshi, me të cilën ka pretenduar se në shkollën fillore “Tefik Çanga” në Ferizaj, në Qendrat e Votimit QV 2501D/01R, 2501D/02R, 2501D/03R, 2501D/04R, 2501D/05R, 2501D/06R, 2501D/07R, 2501D/08R, 2501D/09R, 2501D/010R dhe 2501D/11D, ka pasur pa rregullsi dhe shkelje të rregullave të numërimit, pra PZAP-it i ka kërkuar rinumërimin e Qendrave të Votimit të lartëcekura .

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankeses gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajit, Genc Bekteshi, është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”*.

Prandaj, PZAP-i nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtejte të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL Anr.433/2017 më datën 24.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së